

## KONKURS Për këtë vend të lirë pune

Organizata	OJQ Nevo Koncepti
Projekti:	<i>Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri</i>
Pozita:	Projekt Menaxher
Lokacioni	Kosovë
Kohëzgjatja e thirrjes	20.11.2023 - 30.11.2023

### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

Nevo Koncepti është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 nëntor 2014. Në themelimin e OJQ Nevo Koncepti kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit rom të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

**Vizioni** i ynë është që komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të jenë të integruar në të gjitha sferat e jetës dhe kontribues të barabartë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. **Misioni** ynë është që të angazhohemi për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit dhe në fushat tjera, që ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme të tyre.

Nevo Koncepti bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht Nevo Koncepti në vazhdimësi është duke zbatuar projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji Nëntor 2023 ka filluar të zbatojë projektin „*Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri*“. Projektit është ndarë në katër pjesë:

1. Përmirësimi i përfshirjes në shkollë dhe edukimit të fëmijëve romë
2. Përmirësimi i integritetit në tregun e punës
3. Përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor për romët në Kosovë
4. Përmirësimi i hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave

## 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

„Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri“ është projekt i implementuar nga Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur/KFOS, Nevo Koncepti/Kosovë dhe Drejtësi Sociale/Shqipëri, në partneritet me Karl Kubel Stiftung/KKS dhe me përkrahje financiare të Ministrisë Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik/BMZ. Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e komunitetit rom në arsim, punësim dhe shëndetësi, si dhe fuqizim i shoqërisë civile për politikën publike në nivel Qendror dhe Lokal.

## 3. OBJEKTIVA

Nevo Koncepti kërkon një (1) Projekt Menaxher me përvojë në menaxhimin e projekteve dhe në avokim.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Projekt Menaxheri/ja është përgjegjës për planifikimin, mbarëvajtjen dhe menaxhimin financiar të projektit.
- Përgjegjës/e për zbatimin e aktiviteteve të projektit, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projektit, organizimin e takimeve për planifikimin e planeve të punës lidhur me projektin.
- Menaxhimin në të gjitha aspektet e projektit (riskun, problemet, cilësinë, komunikimin, ndryshimet).
- Vendos afate, cakton përgjegjësi, monitoron, si dhe përmbledh progresin e projektit.
- Menaxhon dhe koordinon punët e punonjësve të projektit.
- Ai/ajo siguron rrjetëzimin dhe koordinimin me institucionet përkatëse vendore dhe hisedarët tjerë.
- Ai/ajo ka përgjegjësinë e përgjithshme për monitorimin dhe vlerësim të projektit.
- Analizon dhe raporton për zbatimin e projektit.

## 4. PËRVOJAT DHE SHKATHTËSITË E NEVOJSHME DHE KUALIFIKIMI

Menaxheri/ja e projektit duhet të ketë aftësi dhe njohuri të nevojshme si në vijim:

- Diplomë universitare në shkencat sociale.
- Të paktën 5 vjet përvojë pune dhe minimumi 3 vjet përvojë në menaxhim të projektit në fushën e hartimit të strategjive, planeve të veprimit në nivelin qendror apo lokal, përvojë të punës në fushën e menaxhimit të mbrojtjes sociale, punës ose dialogut social.
- Të ketë njohuri të mira për sistemin e arsimit, shërbimeve sociale dhe familjare.
- Duhet të ketë përvojë të bashkëpunimit efektiv me institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, me ofruesit e shërbimeve publike dhe me OJQ-të.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës angleze dhe aplikacioneve softuerike që ndërliken me menxhimin e projekteve, përfshirë pakon e MSOffice.
- Shkathësi në shkrim, në komunikim dhe negocijim me institucionet qendrore, lokale, me OJQ-të dhe me komunitetin.

- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

## 5. PROCEDURAT E APLIKIMIT

- CV-ja
- Letër motivimi
- Së paku dy letër referenca
- Dokumentacion shtesë relevant (opcionale)

Të gjithë të interesuarit duhet dorëzuar dokumentacionin aplikues në e-mail adresën: [o.osmani@nevokoncepti.org](mailto:o.osmani@nevokoncepti.org) deri me datë **30/11/2023 në ora 12:00**.

Do të kontaktohen vetëm ata që plotësojnë kushtet e parara me këtë konkurs. Intervistat organizohen në javën e parë të dhjetorit.

Të dhënat personale që do t'i dorëzoni përmes aplikacionit tuaj do të mbrohen dhe përdoren vetëm për qëllime të rekrutimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.